



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË
DREJTORIA E PYJEVE KULLOTAVE DHE BUJQËSISË
SEKTORI PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 2725/11 Prot

B:Curri, më 7. 5. 2025

PROJEKT VENDIM

Mbi propozimin për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Bashkisë Tropojë, të “PLANIT PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QE DUHEN MARRË PËR MBROJTJEN E PYJEVE KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN 2025”.

Në bazë të: Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar); Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” (i ndryshuar); Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”; Ligjit nr. 8766, date 5/4/2001 ”Per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin” (i ndryshuar); VKM Nr. 1186, datë 24.12.2020 “Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”; VKM nr.290 datë 30.04.2004 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota”; VKM Nr. 807 datë 28.12.2023 “Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile”; VKM nr.1080 datë 22/12/2010 “ Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota, si dhe për krijimin e njësisë vullnetare për shuarjen e zjarreve ”; dhe në relacionin bashkangjitur:

I propozojmë këshillit të bashkisë Tropojë:

1. Të miratojë **“PLANIN PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QE DUHEN MARRË PËR MBROJTJEN E PYJEVE KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN 2025”**.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Bujqësisë dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës.

Konceptoi: E.Mulaj

Pranoi: F.Metaliaj

Ligjshmëria:

KRYETARI
Rexhe Byberi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV.KRYETARI
ZYRA ISLAMAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË
DREJTORIA E PYJEVE, KULLOTAVE DHE BUJQËSISË
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 2125/12 Prot

B. Curri, më 2.5.2025

RELACION

Mbi propozimin për shqyrtim dhe miratim nga Këshilli i Bashkisë Tropojë të **PLANIT PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QE DUHEN MARRË PËR MBROJTJEN E PYJEVE KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN 2025**.

Qëllimi kryesor i këtij Plani Masash është : mirëqenia, siguria, paqja dhe harmonia e qytetarëve, ndaj dhe qëllimi që duam të arrijmë është një “kontribut i qëndrueshëm për një jetë më të mirë për shoqërinë sot dhe brezat e së ardhmes”. Mjedisi në përgjithësi dhe pyjet në veçanti, janë skena ku zhvillohet jeta njerëzore, aktiviteti ekonomik dhe ushtrohet qeverisja, ndaj cilësia dhe gjendja e pyjeve kanë një ndikim thelbësor në disa dimensione duke dhënë një kontribut të rëndësishëm në cilësinë e ajrit, ujit, tokës, biodiversitetit, në zhvillimin e bujqësisë, energjisë e turizmit, në uljen e varfërisë, zhvendosjet e popullsisë, zbutjen e konflikteve sociale, në mbrojtjen nga përmbytjet, sigurinë e vendit .

1. Baza ligjore

- Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”(i ndryshuar);
- Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” (i ndryshuar);
- Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” ;
- Ligjit nr. 8766, date 5/4/2001 ”Për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin”(i ndryshuar);
- VKM Nr. 1186, datë 24.12.2020 “Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;
- VKM nr.290 datë 30.04.2004 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota” ;
- VKM Nr. 807 datë 28.12.2023 “Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile” ;
- VKM nr.1080 datë 22/12/2010 “ Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota, si dhe për krijimin e njësisë vullnetare për shuarjen e zjarreve ” ;

2. Historiku i Planit të Veprimit për Pyjet dhe Kullotat bashkiake për Vitin 2025

Rëndësia e pyjeve është e gjithanshme dhe gjithëpërfshirëse, duke i bërë një element thelbësor të jetës sonë.. Zonat pyjore përbëjnë një element thelbësor për zhvillimin e turizmit, si zonat bregdetare, malore apo ato urbane. Krijojnë mundësi për punësim, si përmes operacioneve në pyll, ashtu edhe përmes grumbullimit të bimëve jodrusore Pyjet

janë një burim i mirë për ujërat nëntokësorë, duke siguruar filtrimin e reshjeve në nëntokë dhe mundësi më të mira për një të pijshëm dhe vadije. Shërbejnë për të krijuar breza pyjorë të domosdoshëm për bujqësinë, veçanërisht për kulturat e ndjeshme ndaj erërave. Nga ana tjetër reduktimi i shpejtësisë së erës, krijon mundësi më të mira për pjalmim nga bletët. Pyje për Natyrën: Pyjet kanë e pasi ndikojnë në freskinë e mjediseve, duke ulur njëkohësisht nevojën për energji, shtratin e duhur për biodiversitetin, duke filluar nga insektet e deri tek bletët e zogjtë që përhapin polenin e farërat. Janë një parandalues dhe luftues i mirë i përmbytjeve. Sistemet rrënjore mbajnë tokën të lidhur në rastet e reshjeve të rënda, veçanërisht e nevojshme përgjatë shtretërve të lumenjve. Mbrojtja e pyjeve si një element i kujdesit përfshin disa masa që vijnë si rezultat i veprimeve dëmtuese dhe shkatërruese si prerjet, transporti dhe shitja e paligjshme e lëndës drusore, zjarri, sëmundjet dhe dëmtuesit natyrorë, etj. Pyjet kanë efekte mbi temperaturën si në nivel global, ashtu edhe lokal, pasi ndikojnë në freskinë e mjediseve, duke ulur njëkohësisht nevojën për energji, shtratin e duhur për biodiversitetin, duke filluar nga insektet e deri tek bletët e zogjtë që përhapin polenin e farërat. Pothuajse gjysma e të gjithë specieve në nivel global e zhvillojnë jetën e tyre në pyje. Janë një parandalues dhe luftues i mirë i përmbytjeve. Sistemet rrënjore mbajnë tokën të lidhur në rastet e reshjeve të rënda, veçanërisht e nevojshme përgjatë . Mbrojtja e pyjeve si një element i kujdesit përfshin disa masa që vijnë si rezultat i veprimeve dëmtuese dhe shkatërruese si prerjet, transporti dhe shitja e paligjshme e lëndës drusore, zjarri, sëmundjet dhe dëmtuesit natyrorë, etj. Një ndër problemet që karakterizon sektorin e pyjeve në aspektin e mbrojtjes janë prerjet e paligjshme në nivel të lartë, zjarrëvina e qëllimshme etj. Mjedisi në përgjithësi dhe pyjet në veçanti, janë skena ku zhvillohet jeta njerëzore, aktiviteti ekonomik dhe ushtrohet qeverisja, ndaj cilësia dhe gjendja e pyjeve kanë një ndikim thelbësor në disa dimensione .

Bashkëlidhur me këtë relacion është paraqitur PLANI PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QE DUHEN MARRË PËR MBROJTJEN E PYJEVE KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN 2025 .

Pas diskutimit nga anëtarët prezantë propozojmë të meren vendimet:

1. Të miratojë PLANIT PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QE DUHEN MARRË PËR MBROJTJEN E PYJEVE KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN 2025 .
2. Për zbatimin e këtij Vendimi ngarkohet Drejtoria e Pyjeve Kullotave dhe Bujqësisë, dhe Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit të tij nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Kukës.

Konceptoi: E.Mulaj
Pranoi: F.Metaliaj



KRYETARI
Rexhe Byberi

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV.KRYETARI
ZYRA ISLAMAJ



Nr 2425/P/L

24.07/5/2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJË

DREJTORIA E PYJEVE, KULLOTAVE DHE BUJQËSISË
SEKTORI I PYJEVE DHE KULLOTAVE

PLANI PËR PARANDALIMIN DHE MASAT QE DUHEN MARRË PËR
MBROJTJEN E PYJEVE KULLOTAVE NGA ZJARRI PËR VITIN
2025

Struktura Përgjegjëse për Pyjet dhe Kullotat :

Specialiste Pyjeve Kullotave

Elona Mulaj

Përgjegjës Sektori

Fatbardh Metaliaj

Drejtori

Kujtim Baliaj

KRYETARI

REXHE BYBERI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV.KRYETARJA

ZYRA ISLAMAJ



Përmbajtja:

1. Hyrje
2. Shkaqet kryesore të rënies së zjarrit në pyje/kullota
3. Klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota
4. Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen e zjarreve
5. Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota
6. Veprimet kryesore gjatë zbulimit të zjarrit në pyje/kullota
7. Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor.

1.Hyrje

Bazuar në Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Bashkia Tropojë përbëhet nga 7 njësi administrative, të cilat janë: Tropojë, Margegaj, Bujan, Bytyç, Fierzë, Llugaj dhe Leghibaj . Në zbatim të VKM nr.134 datë 03.03.2021 “Për disa ndryshime në VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktulisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të ish komunave/bashkive” të ndryshuar Bashkisë Tropojë administron në total një fond prej 49 770,91 ha pyje . Sipërfaqja e madhe e kësaj pasurie, rëndësia e saj por edhe shpërndarja e madhe bën që ti kushtohet një rëndësi e madhe administrimit dhe mbrojtjes nga zjarri . Zjarret në pyje në vitin e fundit paraqesin një problem serioz për pyjet në Bashkinë Tropojë. Dëmet e këtyre zjarreve kapin vlera të konsiderueshme, kosto këto që përfshijnë dëmet direkte si edhe kostot për të riparuar pasojat e zjarreve. Përveç dëmit ekonomik, qe mund të shprehet në të holla, dëmi i shkaktuar në biocenozën e pyllit, pra dëmi ekologjik, është gjithashtu i madh dhe nuk mund të shprehet dot në mënyrë financiare.

2.Shkaqet kryesore të rënies së zjarrit në pyje/kullota

Arsyet e rënies së zjarreve janë nga më të ndryshmet , por në bazë të përvojave dhe njohurive të deritanishme në 99% të rasteve të shfaqjes së këtyre zjarreve si shkak paraqitet njeriu (direkt ose indirekt). Rrufeja apo vetëndezja e pyjeve kap vetëm 1% të rasteve. Renia e zjarreve në pyje/kullota ku shkaktar është njeriu ndodh nga pakujdesia , padituria apo qëllim i pastër . Këto zjarre ndodhin zakonisht në pranverën e hershme kur vegjetacioni baror nga viti i kaluar është i thatë dhe vegjetacioni i ri akoma nuk ka filluar. Këtu si shkaktarë të zjarreve janë mbledhësit e frutave pyjore, bimëve medicinale , gjetarët, fermerët, barinjtë . Zjarret e qëllimshme bëhen me qëllim që të zgjerojnë tokën e punueshme apo kullotat, ku njeriu ndez zjarrin pa llogaritur pasojat. Motivet e këtyre zjarreve janë nga më të ndryshmet , ato mund të jenë edhe për përfitim ekonomik , për përfitim dru të lirë, për dru zjarri apo ndërtim, për të mbuluar prerjet ilegale etj.

3.Klasifikimi i zjarreve në pyje/kullota

Sipas llojeve të zjarreve në pyje mund ti specifikojmë në:

- Zjarr nëntokësor ose nënsipërfaqësor
- Zjarr sipërfaqësor ose pranë nëntokës
- Zjarr në kurotat e drurëve
- Zjarr i përgjithshëm ose i kombinuar

Më i përhapur tek ne janë tre rastet e fundit :

Zjarri sipërfaqësor është zjarri në të cilin djegia aktive zhvillohet në sipërfaqe të tokës dhe digjet përgjithësisht bimësi pranë tokës në sipërfaqe si bar, filiza, shkurre etj. Në varësi të kushteve dhe pranisë së erës flakët e zjarrit mund të arrijnë deri në 2m. Në rajonet e rafshëta djegia intensive zakonisht ndjek buzët e zjarrit, ndërsa në zonat kodrinore-malore ajo zhvillohet në ballin e zjarrit. Zjarri në kurorat e drurëve është një zjarr që ndodh vetëm në kulm apo kurorë të drurëve. Ky lloj zjarri mund të jetë fillësia e një zjarri të kombinuar për shkak të kushteve specifike të djegies gjatë këtyre zjarreve, shpejtësia e përhapjes arrin deri në 20km/h. Zjarri i përgjithshëm ose i kombinuar përfshin djegien sipërfaqësore si edhe si edhe atë të kurorave. Shkalla e përhapjes së këtyre zjarreve në vartësi të terrenit, llojit të drurëve si edhe shpejtësisë së erës mund të arrijë deri në 20 km/h. Vetë përhapja e zjarrit zakonisht zhvillohet në tre faza: faza fillestare, kërcënimi i zjarrit dhe faza e qetësimit. Zjarrfikësit dhe jo vetëm, duhet të njohin mirë mënyrën dhe fazat e përhapjes së zjarrit në mënyrë që të shmangin rrezikun të gjenden mes dy zjarreve në momentin që ndodh kërcimi i zjarrit dhe kështu vihen nën kërcënim jetët e tyre.

4.Faktorët që ndikojnë në rritjen e rrezikut për shfaqjen e zjarreve.

Më të rëndësishmit janë :

- Lloji i bimësisë
- Topografia
- Stina vjetore
- Karakteristikat klimaterike
- Komunikacioni

Lloji i bimësisë është një nga faktorët kryesorë që ndikojnë në shkallën e rrezikut nga zjarret. Kështu pyjet halorë ndizen më lehtë se ato gjethërenës. Drurët dritëdashës janë më të rrezikuar kjo për shkak se përbërja e pyllit me këto lloje drurësh është me i rrallë. Kështu llojet e bimëve që ndizen lehtë dhe e mbështesin fuqimisht djegien quhen specie bimore “profibe” (pishë, bredh etj).

Topografia apo relievi i terrenit, së bashku me llojin e tokës luan një rol të rëndësishëm në shkallën e ndezshmërisë të materialit djegës. Në përgjithësi në terrenet të cilët kanë relief të fortë me orjentim nga jugu është lehtësisht më i ndezshëm se ai i orientuar nga veriu. Kjo edhe për vetë faktin e bimësisë që rritet në të.

Stinët me karakteristikat e tyre ndikojnë në ndezshmërinë e pyjeve. Vera me temperatura të larta të ajrit dhe periudha të gjata pa shi e rritin shkallën e ndezshmërisë në pyje/kullota. Në këtë periudhë bari thahet, lagështia e tokës zvogëlohet në mënyrë drastike dhe përbën rrezik për zjarr. Kështu kjo periudhë quhet “periudhë kritike e vitit për shfaqjen e zjarreve në hapësirë të hapur”. Edhe gjatë periudhës së dimrit për shkak të temperaturave shumë të ulta kryesisht kur dimri është i thatë, për shkak të lagështisë së ulët të tokës, materiali djegës mund të ndizet lehtësisht.

Komunikacioni. Ashtu sic kemi vënë re , shkaku kryesor i zjarreve (me apo pa qëllim) është njeriu. Hapja e rrugëve në zonat e pyjeve apo në afërsi të tyre përdorimi për piknik, rekreacion mbledhjen e produkteve të ndërmjetme pyjore përbën rrezik për zjarr. Por nga ana tjetër pavarësisht efektit negativ , është edhe ai pozitiv i cili mundëson një kontroll më të mirë të zonës apo qasje më të shpejtë të zjarrfikseve dhe automjeteve në rast zjarri.

5.Masat për parandalimin e zjarreve në pyje/kullota

Të gjitha masat që merren për parandalimin e zjarreve sipas kohës kur ndërmeren dhe me çfarë qëllimi , ndahen në :

a. Masa preventive

b. Masa përgatitore

c. Masa direkte

a. Masat preventive

a. Masa preventive

Janë masa mbrojtje kundër zjarreve që merren vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Kjo për shkak se njeriu është shkaktar i tyre në 99% të rasteve edhe këto masa janë të përqëndruara plotësisht ndaj njeriut.Qëllimi final është të parandalohet shkaktimi i zjarreve dhe të zvogëlohet numri i këtyre zjarreve. Në këtë kuadër këto masa janë :

Masa ligjore , mbrojtja e pyjeve/kullotave rregullohet me ligje dhe akte nënligjore ku mbrojtja e tyre është përgjegjësi e të gjithëve por edhe e pronarëve (bashkisë apo subjekteve private) si edhe subjekteve që i menaxhojnë ato.

Masat edukative , këto janë masa të cilat në vetvete përfshijnë edukimin e njerëzve dhe përdoren për të gjithë grupmoshat, mgjs më të përdorurat janë për të rinjtë deri në 18 vjet. Mënyrat janë nga më të ndryshmet që nga mësimet në librat shkollorë , leksione të hapura për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret, përdorimi i revistave, fletpalosjeve, internetit, tv etj.

Masa informative- propagandistike , qëllimi i tyre është për të paralajmëruar dhe informuar njerëzit për rreziqet nga paraqitja e zjarreve në pyje si edhe për të informuar se si duhet të sillemi gjatë qëndrimit në pyll.Kjo masë kombinohet edhe me atë edukative.

b.Masa përgatitore.

Duke patur parasysh që masat preventive nuk e zgjidhin plotësisht problemin e mbrojtjes së pyjeve nga zjarret , është e domosdoshme marrja e masave përgatitore Këto masa kanë një natyrë të përhërëshme gjatë gjithë vitit dhe përfshihen :

Zbulimi në kohë i zjarrit

Transferimi i Informacionit mbi zjarrin

Organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve

Ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit

Përgatitja e planit operativ vjetor për mbrojtjen e pyjeve nga zjarret.

Zbulimi në kohë i zjarrit është i një rëndësie të madhe për lokalizimin dhe fikjen shpejt të tij. Zonat tona malore kanë një dukshmëri të dobët, me qëllim që zjarri të mund të zbulohet në kohë organizohet shërbimi i monitorimit në terren nga vëzhguesit kundra- zjarr / vrojtuesve kryesisht me patrullim nga toka në periudhën më të rrezikuar të vitit. E rëndësishme për këtë fazë është që nëpërmjet institucioneve qendrore (ministri/ agjensi etj) dhe jo vetëm të kryhet monitorimi nga ajri , mbikqyrje automatike apo elektronike si edhe vezhgimi satelitor. Masa keto të cilat do të mundësojnë zbulimin dhe monitorimin e këtyre zjarreve.

Transferimi i informacionit mbi zjarrin i kryer në mënyrë të shpejtë dhe ka efektin e dëshiruar. Dhënia e këtij informacioni bëhet nëpërmjet telefonit apo edhe sinjalet e tjera si flamuj etj. Qytetarët të cilët zbulojnë zjarre në pyje/kullota duhet të njoftojnë në nr e tel 128 Shërbimin Zjarrfikës . Një organizim më i mirë në mënyrën e transferimit të informacionit do të jetë nëpërmjet radiove- lidhese apo ndërtimit të rrjetit te marrje-dhënie nëpërmjet pajisjeve vëzhguese në të gjithë territorin e mbuluar me pyje.

Organizimi i zjarrfiksave dhe vullnetarëve deri tek vatra e zjarrit është shumë e rëndësishme për këtë arsye duhet njoftuar menjëhere me zbulimin e zjarrit. Transporti i organizuar i zjarrfiksave dhe pajisjeve mënyra e organizimit të tyre dhe vullnetarëve krijon premisa për menaxhim të mira të situatës së zjarrit.

Ndërtimi i hendeqeve kundra zjarrit shërben si si një pozicion mbrojtës për zjarrfikësit por edhe vullnetarët.për këtë arsye hendeqet ekzistuese në pyje duhet të jenë gjatë gjithë kohës të pastruar nga materiali djegës . Hapja e hendeqeve dhe dimensionimi i tyre (gjerësia) është e ndryshme në vartësi nga lartësia e pemëve, pjerësia e terrenit etj. Psh nëse pemët janë rreth 20m , gjerësia e hendekut do të jetë minimuni 40cm.

masa direkte

arësisht nga masat më të mira preventivetë marra , zjarret përsëri ndodhin. Për këtë arësye përdoren masat direkte. Këto janë masa të cilat ndërmerren gjatë kohëzgjatjes së zjarrit dhe bëjnë lokalizimin dhe shuarjen e tij. Për të lokalizuar apo shuar një zjarr është e nevojshme të shpërndahet një nga elementet nga i ashtuquajti trekëndësh i Osborn-it, përkatësisht materiali djegës, oksigjeni, energjia termike dhe veprimi i nxehtësisë apo oksigjeni.

Asasaj se cili material ose mjet përdoret për këtë qëllim , metodat e shuarjes ndahen në:

- Shuarje e zjarrit me tokë, metoda më e vjetër e përdorur për këtë qëllim , ku materiali i tokës përdoret si izolator , pra largon elementin oksigjen nga materiali djegës. Toka gjithashtu vepron si një izolant i nxehtësisë , përkatësisht energjia termike për djegien e drurit.
- Shuarje e zjarrit me ujë, edhe kjo një ndër metodat tradicionale në shuarjen e zjarreve. Veprimi i ujit në procesin e shuarjes është i shumëfishtë.
- Luftimi i zjarrit me zjarr , megjithëse duket si konfuze, kjo metodë është efektive por mbart në vetvete rrezik dhe kërkon persona të trajnuar dhe me përvojë. Në vartësi të taktikës për lokalizimin dhe shuarjen e zjarrit, në një distancë të caktuar nga zjarri ndizet një “ zjarr i kontrolluar” (që mund të lëvizë në drejtim të kundërt ose të njëjtë me drejtimin e lëvizjes së zjarrit) i cili djeg materialin para frontit të zjarrit , kur zjarri arin në atë sipërfaqe, nuk ka cfarë të djegë dhe zjarri shuhet.
- Shuarje e zjarrit nga ajri nëpërmjet aeroplanëve është përdorur për herë të parë në vitin 1930. Në përgjithësi kjo është një metodë uji ose kimikatesh , por për shkak të specifikës është e vështirë si metodë e vecante. Është metodë mjaft e shpejtë dhe efikase sidomos për rastet e tërreneve malore .
- Shuarja e zjarrit me kimikate , në këtë rast përdoren kimikate të ndryshme. Kjo metodë alternohet me atë të ujit sepse në përgjithësi këto kimikate shpërbëhen nëpërmjet ujit. Llogaritet se 70% e ujit që përdoret në shuarjen e zjarreve harxhohet pa efektivitet , për këtë arësye ujit i shtohen kimikate të ndryshme të cilat përmirësojnë efekun e shuarjes së zjarrit.
- Shuarje e zjarrit me eksploziv, përdoret kryesisht si metodë ndihmëse. Kryesisht për të rrezuar pemë, gërmim kanalesh, krijim pengesash etj. Në rastet e shpërthimeve krijohet “ re e pluhurit” e cila ul përqindjen e oksigjenit në ajër rrjedhimisht zjarri ul intensitetinose shuhet plotësisht.

6. Veprimet kryesore gjatë zbulimit të zjarrit në pyje/kullota

Detyrë qytetare e cdo individi , në rast se zbulon zjarr në pyll/kullotë, është që të njoftojë sa më shpëjt të jetë e mundur institucionet përgjegjëse. Nga shpejtësia e informimit, saktësia dhe përmasjtja varret suksei i aksionit të shuajtjes së zjarrit.

Hapat që duhet të ndërmerren janë:

1. Telefononi nr **128** pa pagesë i Shërbimit Zjarrfikës.
2. Prezantoni veten me emër e mbiemër.
3. Tregoni se ku jeni (vendndodhjen e saktë).
4. Tregoni vendndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orjentuese me ta sakta, emrin e vendit , vendbanimit më të afërt apo objekte te njohura)
5. Tregoni llojin e bimësisë që po digjet (dru , shkurre , bar etj)
6. Nëse vëreni dicka të dyshimtë afer vatrës së zjarrit psh automjet mundohuni të shënoni targën apo ta mbani mend.
7. Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin me mjete rrethanore atëhere ndërhyini, ne të kundërt largohuni në një distancë te sigurt.
8. Me qëllim që të kuptoheni me personin në telefon jeni të lutur të flisni qartë dhe ngadalë.

Informacioni i dhënë në këtë mënyrë është i saktë dhe përmban të gjitha elementet e nevojshme, përcaktimi i vatrës së zjarrit, lloji i materialit djegës, nëse zjarri ka qënë i qëllimshëm etj.

7. Plani i masave për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor

Baza Ligjore :

- Ligji nr. 139 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- Ligji nr. 57/2020 “Për pyjet” (i ndryshuar);
- Ligji nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile” ;
- Ligjit nr. 8766, date 5/4/2001 ”Per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin” (i ndryshuar);
- VKM Nr. 1186, datë 24.12.2020 “Për miratimin e listës së objekteve me rëndësi ekonomike e strategjike, pranë të cilave ngrihen stacionet e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit”;

- VKM nr.290 datë 30.04.2004 “Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota” ;
- VKM Nr. 807 datë 28.12.2023 “Për miratimin e planit kombëtar për emergjencat civile” ;
- VKM nr.1080 datë 22/12/2010 “ Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje e kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare për shuarjen e zjarreve ” ;

Përkufizime:

“Rrezik zjarri” është situata e krijuar nga akumulimi i faktorëve që nxitin mundësinë e nisjes së zjarrit dhe zhvillimit të tij.

“Sisteme të diktimit-sinjalizimit” janë pajisje që diktojnë, sinjalizojnë shfaqjen e tymit, gazrave dhe zjarrit.

“Shërbimi vullnetar i mbrojtjes nga zjarri” është organizimi i strukturës vullnetare për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, nga organet e njësitë e qeverisjes vendore, nga personat juridikë, që kryejnë veprimtaritë e tyre në Republikën e Shqipërisë, nga institucione dhe agjenci shtetërore, të cilat kanë përgjegjësi për administrimin e pasurive shtetërore me rrezikshmëri nga zjarri.

“Zjarr” është dukuria e djegies, e shoqëruar me nxehtësi të lartë, tym dhe dritë në formë flakësh përcëlluese.

“Zjarr normal” është zjarri që shkakton dëm, për përballimin e të cilit janë të mjaftueshme forcat operacionale, mjetet dhe pajisjet e stacionit zjarrfikës të bashkisë.

“Zjarr masiv” është zjarri që zhvillohet apo tenton të zhvillohet në sipërfaqe e volume të konsiderueshme, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës i një stacioni, kërkohet edhe pjesëmarrja për ndihmë nga stacionet zjarrfikëse të bashkive të tjera.

“Zjarr me përmasa të mëdha” është zjarri që zhvillohet në sipërfaqe e volume të mëdha, për përballimin e të cilit, përveç forcave operacionale, mjeteve e pajisjeve që zotëron shërbimi zjarrfikës, kërkohet edhe pjesëmarrja, për ndihmë, e forcave e mjeteve të shërbimeve apo strukturave të tjera operuese.

“Organizim i ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtim” është tërësia e masave tekniko-organizative të nevojshme, për organizimin e forcave të ndryshme, mjeteve, pajisjeve zjarrfikëse, metodave e taktikave, të cilat përdoren për ndërhyrjen në shuarjen e zjarrit, evakuimin dhe shpëtimin e jetës së njerëzve, kafshëve dhe pronës.

"Mbrotjtja e pyjeve dhe e tokës pyjore" është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pyjeve të burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë.

"Mbrotjtja e pyjeve dhe e tokës pyjore" është veprimtaria për parandalimin e degradimit, përtëritjen, ruajtjen dhe përmirësimin e pyjeve të burimeve pyjore e jopyjore bashkëshoqëruese dhe të mjedisit pyjor nga faktorët njerëzorë e natyrorë.

Në rast se në fondin pyjor ose në një pjesë pylli dhe në shkurre bie zjarr, sektori i pyjeve dhe kullotave, organet e njësive të qeverisjes vendore, çdo subjekt shtetëror a privat, njësi apo repart ushtarak, shkollë, institucion publik e privat, si dhe çdo shtetas kanë detyrë të njoftojnë dhe të marrin pjesë për shuarjen e tij.

Bashkia Tropojë me strukturat e saj , Njesitë Administrative , Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave, në zbatim të dispozitave ligjore si më sipër , për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në fondin pyjor/kullosor në administrim të saj parashikon marrjen e masave organizative si më poshtë:

-Në rastet e zjarreve në pyje/kullota në territorin e Bashkisë Tropojë ngrihet dhe funksionon shtabi i Mbrotjtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi i cili drejton dhe organizon gjithë veprimtarinë për "Organizimin e ndërhyrjes në shuarjen e zjarrit dhe shpëtimit".

- Në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Tropojë ngrihet shtabi i MNZSH-së i përbërë nga punonjësit e mëposhtëm :

1 – Kujtim Baliaj Drejtori DPKB

2 – Jetnor Tafaj Nj.Adm Tropojë

3 – Ramiz Sokoli Nj.Adm Bujan

4 – Drilon Toskaj Nj.Adm Bytyç

5 – Shaqir Osmanaj Nj.Adm Fierzë

6 – Ardit Qehaja Nj.Adm Lekbibaj

7 – Agim Hasanpapaj Nj.Adm Llugaj

- Të gjitha NJA të Bashkisë Tropojë të organizojnë/riorganizojnë "Shërbimin vullnetar të mbrotjtjes nga zjarri" . Këto skuadra përbëhen disa anëtarë dhe do të mbahen në eficiencë të plotë nga NJA nëpërmjet Inspektorëve pyjorë . Skuadra e "Shërbimit vullnetar të mbrotjtjes nga zjarri" do të jënë strukturat e para që së bashku me strukturat e tjera pyjore do të mbajnë nën kontroll zjarrin .

Afati i realizimit : prill 2025

- Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore/kullosore , vrojtuesi/sinjalizuesi kryen veprimet si më poshtë:

1.Njofton menjëherë në numrin e **telefonit 128 Shërbimin Zjarrfikës** dhe **nr 126 ose 129 të Policisë së Shtetit** ku prezanton veten me emër e mbiemër, tregon se ku jeni (vendndodhjen e saktë), tregon vendndodhjen e zjarrit (duke dhënë pikat orjentuese me ta sakta, emrin e vendit , vendbanimit më të afërt apo objekte te njohura), tregoni llojin e bimësisë që po digjet (dru , shkurre , bar etj).

2.Njofton Administratorin e Nj.Adm ku ndodhet vatra e zjarrit.

3.Nëse vlerësoni se mund të shuani zjarrin me mjete rrethanore atëhere ndërhyini, ne të kundërt largohuni në një distancë te sigurt.

Në rastet e shfaqjes së zjarrit në zonë pyjore/kullosore , dhe marrjen e njoftimit nga vrojtuesi/sinjalizuesi , Administratori i Nj.Adm , kryen veprimet si më poshte:

1. Njofton kryetarin e Shtabit .

2. Njofton Strukturën Njësitë Vullnetare për shuarje Zjarri e cila është ngritur dhe funksionon pranë Nj.Adm në fjalë.

3.Të gjithë bashkë organizohen per shuarjen e zjarrit ose lokalizimin e tij deri në mbrritjen e forcave të specializuar të mbrojtjes nga zjarri.

-Shtabi për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi mblidhet në çdo kohë që shihet e arsyeshme nga Kryetari saj. Në këto mbledhje do të analizojë gjendjen dhe do të përcaktoje masat ne vijueshmëri në perputhje me situatat që mund te krijohen. Përgatit dhe publikon komunikaten dhe informacione të tjera të nevojshem ne funksion te situates për punën e bëre në mbrojtjen e Pyjeve dhe Kullotave nga zjarret.